



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:267725
Datë: 17.05.2024
Numri i dokumentit: 05699919

AA.nr.552/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët; Hajriz Hoti kryetar, Ramiz Kuqi dhe Delushe Halimi anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Hajrije Krasniqi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, K.M-Përmbaues Privat, kundër të paditurës, Qeveria e Kosovës, Ministria e Drejtësisë-Komisioni Disiplinor për Përmbauesit Privat, i përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, përkitazi me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2722/2019, të datës;26.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë;13.05.2024, merr këtë,

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës, Qeveria e Kosovës, Ministria e Drejtësisë, Komisioni Disiplinor për Përmbauesit Privat, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2722/2019, i datës; 26.04.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2722/2019, të datës;26.04.2023, është vendosur, *“I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpapia e paditësit K.M nga Prishtina. II. ANULOHET vendimi i të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Drejtësisë – Komisioni Disiplinor për Përmbauesit Privat me numër protokolli 24/2019 te datës 17.10.2019 dhe çështja i kthehet të paditurës në rishqyrtim dhe rivendosje.”*

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë e paditura, Qeveria e Kosovës, Ministria e Drejtësisë, Komisioni Disiplinor për Përmbauesit Privat, përmes Avokaturës Shtetërore, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës, të refuzohet kërkesëpapia e paditësit dhe të prish aktgjykimin A.nr.2722/19, të datës;26.04.2023, si i kundërligjshëm dhe çështjen ta kthen në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka ushtruar pala paditëse.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre duke u bazuar në nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 194 dhe 195.1 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka gjetur se ankesa e të paditurës është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datë:18.11.2019, kundër vendimit të paditurës, Qeveria e Kosovës, Ministria e Drejtësisë-Komisioni Disiplinor për Përmbauesit Privat, sepse konsideron se qëndrimi i të paditurës me rastin e vlerësimit se paditësi ka kryer shkelje disiplinore në bazë të Udhëzimit Administrativ MD-nr.06/2014, se është cenuar parimi themelor i Kodit të Përkohshëm të Etikës së Përmbauesit, është absurd dhe nuk është i mbështetur në prova konkrete. Prandaj nga arsyet e theksuara si më lartë, i ka propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesë padia e paditësit dhe të anulohet vendimi i të paditurës-Komisionit Disiplinor për Përmbauesit Privat.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit të paraqitur kundër vendimit të paditurës, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të seancës së shqyrtimit kryesor, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin e aprovon si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetim se *“Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit, të goditur me padi, në përputhje me nenin 43.3 të LKA-së dhe provave të administruara, thëniet e padisë, përgjigjes dhe deklamimit ne seancën e shqyrtimit kryesor, ka vendosur në mënyrë meritore, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Me rastin e vlerësimit të ligjshmërisë se aktit të kontestuar me padi kjo gjykatë iu referua dispozitave ligjore të nenit paragrafi 3 te nenit 368 i Ligji nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaimore ku shprehimisht parashihet: “Masat disiplinore për shkeljet disiplinore janë si në vijim: 1.1. vërejtja; 1.2. vërejtja publike; 1.3. gjoba në të holla nga pesqind (500) deri tremijë (3000) Euro; 1.4. ndalimi i ushtrimit të profesionit në kohëzgjatje prej tre (3) muaj deri në një (1) vit; 1.5. shkarkimi nga detyra. Ministri mund ta suspendoj përmbauesin privat gjatë kohës sa zgjatë procedura disiplinore. 3. Gjodat në të holla nga nënparagrafi 1.3. i paragrafit 1. i këtij neni paguhet në buxhetin e Republikës së Kosovës. ” Neni 369 LPP-së, Komisioni Disiplinor zbaton procedurën disiplinore për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore të përmbauesit privat dhe shqipton masat disiplinore në pajtim me këtë ligj. (e shtuar). Gjykata morri parasysh edhe Udhëzimin Administrativ (MD), Nr.06/204 Për Tarifat për Shpërblimet dhe Kompensimin e Shpenzimeve për Përmbauesit Privat përkatësisht nenin 6, ku përcaktohet lartësia e shumës se shpërblimit dhe kompensimit se: “Lartësia dhe kompensimi i shpenzimeve për veprimet e ndërmarrë përcaktohet sipas llojit të veprimit të ndërmarrë dhe kohëzgjatjes së atij veprimi, të paraparë në Tabelën 2, me ç’rast përmbauesi privat është i detyruar ti ndërmerr në mënyrën që për palët ekonomikisht janë më të volitshme”. Ne bazë të UA nr.07/14 me nenin 2 par.1 të Kodit të Etikës së Përmbauesve Privat përcakton : “Përmbauesi privat si bartës individual i shërbimit publik e kryen shërbimin e vet me ndërgjegje, ndershëm dhe në mënyrë të paanshme në pajtim me kushtetutën dhe ligjin”. Nga vendimi i kontestuar del se ai përmban të meta për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me dispozitat e këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbaj përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti, etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Po me të njëjtin ligj, parashihet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve,*

duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtën dhe interesat ligjor ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar, etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit. Vendimi i kontestuar nuk përmban arsyet për vendosjen si në dispozitiv të tij, por vetëm citim të dispozitave ligjore. Për më tepër, vendimi përbëhet vetëm prej tre faqeve ku në faqen e dytë fjalia është e papërfunduar ndërsa faqja e tretë nuk lidhet në kontinuitet me faqen e dytë. Në këtë kuptim, gjykata konsideron se nga vendimi i kontestuar nuk mund të kuptohet se mbi çfarë baze paditësi është shpallur përgjegjës dhe se mbi cilën bazë i është shqiptuar gjoha në shumë prej 3000 (tremijë) Euro, përderisa paditësi ka bashkangjitur dokumente (ekspertizën financiare si dhe faturën), me të cilat ka dëshmuar shpenzimet e ngarkuara për palën ankuese. Gjykata si rregull, konfliktin administrativ e vendosë në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga aktvendimi i goditur me padi, nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike. Të metat e cekura më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e palës së paditur si në përgjigje në padi, mirëpo që të njëjtat i konsideroi jo relevante për vendosje ndryshe si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.”

Qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kolegji i apelit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m), për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale gjithashtu është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Sa i përket pretendimit ankimor se Gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës administrative, sipas vlerësimit të kolegjit të apelit ky pretendim nuk qëndron, ngase e paditura të njëjtës shkelje vetëm iu ka referuar si shkelje në hyrje të ankesës, por nuk ka theksuar saktë, përkatësisht, nuk ka specifikuar asnjë dispozitë konkrete se ku qëndrojnë shkeljet esenciale të LPPA-së, megjithatë kolegji i apelit vëren se Gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPPA-së, dhe se aktgjykimi është hartuar në pajtim me nenin 160 të LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor se Gjykata e shkallës së parë ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale, “*se gjykata nuk u bazua në faktet e dhëna nga e paditura*”. Kolegji i apelit nuk e aprovoi këtë pretendim ankimor, sepse vlerësoi se i njëjti është i pa qëndrueshëm dhe i pa argumentuar me prova konkrete të cilat do të gjente mbështetje ligjore, dhe si i tillë është pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Gjykata e shkallës së parë, kur ka konstatuar se “*nga vendimi i kontestuar nuk mund të kuptohet se mbi çfarë baze paditësi është shpallur përgjegjës dhe se mbi cilën bazë i është shqiptuar gjoha në shumë prej 3000 (tremijë) Euro, përderisa paditësi ka bashkangjitur dokumente (ekspertizën financiare si dhe faturën), me të cilat ka dëshmuar shpenzimet e ngarkuara për palën ankuese.*” Dhe mbi këtë

gjendje faktike të vërtetuar kolegji i apelit vlerëson se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Sipas vlerësimit të kolegjit të apelit aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kolegji i apelit. Prandaj ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këto arsye, e në mbështetje të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 200 dhe 195.1 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.552/2023, datë;13.05.2024

Kryetari i kolegjit,
Hajriz Hoti